

Emri i Lëndës : E Drejtë Kushtetuese I

Kodi	Tipi	Semestri	Leksione (orë/javë)	Seminare (orë/javë)	Lab (orë/javë)	Kredite	ECTS
LAW 115	A	Vjeshtë	3.00	1.00	0.00	3.50	5.00

Lektori	Ferdinand Gjana, Prof. Dr
Asistenti	Enkelejd Alibeaj, Msc
Gjuha e kursit	Shqip
Niveli i lëndës	Program i Integruar
Përshkrimi	Lënda do të fokusohet në shpjegimin e parimeve kryesore dhe institucioneve të së drejtës publike, të tilla si shteti dhe e drejta, parimet e sovranitetit shtetëror, ndarjen e pushteteve, karakteristikat kryesore të shteteve dhe sistemet shtetërore. Në pjesën e parë, studentët njihen me rolin e teorisë së të drejtës në shkencat juridike në përgjithësi dhe në studimet juridike. Shpjegohen teoritë më të rëndësishme për origjinën e shtetit dhe të së drejtës dhe për shkencat juridike në përgjithësi. Më pas analizohet struktura e shtetit, organet dhe funksionet e tij. Në vijim diskutohen elementet e shtetit dhe trajtat e tij. Në pjesën e dytë paraqitet koncepti i normave juridike, ndarja e normave juridike bazuar në kriteret e ndryshme si dhe struktura e normave juridike. Analizohet koncepti i marrëdhënieve juridike dhe diskutohen elementet bazë të marrëdhënies juridike (subjektët e së drejtës, objekti i së drejtës, e drejta subjektive dhe detyrimi juridik). Shpjegohet koncepti i aktit juridik dhe diskutohen burimet e së drejtës (kushtetuta, ligji, aktet shtetërore nënligjore, aktet e personave publik dhe privat, e drejta zakonore, si dhe shkenca juridike). Pjesa e tretë paraqet studimin e konceptit të sistemit juridik dhe diskutohen njësitë themelore të sistemit juridik (norma juridike, institutet e së drejtës, degët e së drejtës, grupet e së drejtës). Më tutje, shqyrtohen teknikat themelore të interpretimit, mënyrat e zgjidhjes së çështjeve rreth zbrazëtirave juridike. Së fundi, shqyrtohen teoritë të ndryshme në lidhje me esencën dhe strukturën e së drejtës (teorisë së të drejtës natyrore, shkollën historike, teoritë e pastër e ligjit, etj).
Objektivat	
Konceptet Kryesore	1. E drejta 2. Kushtetuta 3. Norma Juridike 4. Parime 5. Institucionet Publike 6. Pushtetet 7. Institucionet e pavarura

Programi i Lëndës

Java	Tema
1	Koncepti i së drejtës publike. Shoqëria, shteti dhe e drejta. Ky leksion i dedikohet zërvatimit teorik të lëndës. Studentët njihen me rolin e teorisë së të drejtës në shkencat juridike në përgjithësi dhe në studimet juridike. (Kapitulli 1)
2	Shteti; Koncepte të ndryshme për shtetin; Pushteti shtetëror dhe sovraniteti. Shpjegohen teoritë më të rëndësishme për origjinën e shtetit dhe të së drejtës dhe për shkencat juridike në përgjithësi. Më pas analizohet struktura e shtetit, organet dhe funksionet e tij. (Kapitulli 2)
3	Pushteti shtetëror dhe sovraniteti. Shpjegohen teoritë më të rëndësishme të pushtetit shtetëror dhe sovranitetit. Mënyrat e ushtrimit të pushtetit. Kujt i përket sovraniteti. Po ashtu ushtrimi i sovranitetit përmes përfaqësuesve. (Kapitulli 3)
4	Forma e shtetit; Parimi i unitetit të pushtetit. Në vijim diskutohen elementet e shtetit dhe trajtat e tij. Njëkohësisht në leksion përshihen forma të ndryshme të shtetit duke i pasqyruar me shembuj konkret. Uniteti i pushtetit trajtohet specifikisht në një ore leksioni të veçantë. (Kapitulli 4)
5	Parimi i ndarjes së pushteteve. Analizimi i pushteteve me rradhe; Pushteti Legjislativ, Pushteti Ekzekutiv dhe Pushteti Gjyqësor. Ndarja dhe Balancimi i pushteteve dhe kontrolli i ndërsjellë i tyre. (Kapitulli 5)

6	Organizmi politik i shoqërisë dhe struktura e shtetit. Analizohet koncepti i marrëdhënieve juridike dhe diskutohen elementet bazë të marrëdhënies juridike: subjektët e së drejtës, objekti i së drejtës, e drejta subjektive dhe detyrimi juridik. Njekohesisht, leksioni pason leksionin e mëparshëm duke u fokusuar në strukturat kryesore të shtetit. (Kapitulli 6)
7	E Drejta, kuptimi i se drejtes; norma juridike. Shpjegohet koncepti i aktit juridik dhe diskutohen burimet e së drejtës (kushtetuta, ligji, aktet shtetërore nënligjore, aktet e personave publik dhe privat, e drejta zakonore, si dhe shkenca juridike (Kapitulli 7)
8	Provimi Norma juridike; Koncepte të ndryshme për të drejtën. Nocioni i rendit juridik; Nocioni i normës juridike; Llojet e normave juridike; Vlefshmëria e normës juridike në territor (hapësirë); Vlefshmëria kohore e normave juridike; Fuqia prapavepruese (retroaktive) e normave juridike; Struktura e normës juridike (Kapitulli 8)gjysmë final
9	Shteti dhe e drejta në evolucionin e tyre historik. -shqyrtohen teori të ndryshme në lidhje me esencën dhe strukturën e së drejtës (teorisë së të drejtës natyrore, shkollën historike, teori e pastër e ligjit, etj (Kapitulli 9)
10	Koncepti i burimit të se drejtës. Trajtohen burimet e se drejtes, origjina e tyre, burimet akte dhe burimet fakte (Kapitulli 10)
11	Burimet kryesore të se drejtës. Trajtim i specifikuar në secilin prej burimeve kryesore të se drejtes, që nga ligji themelor i vendit, marrëveshjet ndërkombetare të ratifikuara (e drejta ndërkombetare), ligjet dhe zakoni (Kapitulli 11)
12	Marrëdhëniet juridike; Faktet juridike Elementet e marrëdhënies juridike; Subjektet e së drejtës (Personat fizikë dhe Personat juridik); Autorizimi juridik (E drejta subjektive, Keqpërdorimi i autorizimit, Keqpërdorimi i së drejtës subjektive, Kompetenca dhe Keqpërdorimi i kompetencës); Obligimi juridik (detyrimi) Gjendja juridike (statusi); Objekti i së drejtës Faktet juridike Parashkrimi (Kapitulli 12)
13	Zbatimi i se drejtës; Llojet dhe menyrat e interpretimit të ligjit Katër teoritë më të rëndësishme të së drejtës; E drejta natyrore; Pozitivizmi ligjor; Realizmi ligjor; Studimet kritike të së drejtës (Kapitulli 13)
14	Sistemi i se drejtës; Parimet e ndërtimit të sistemit të se drejtes. -paraqet studimin e konceptit të sistemit juridik dhe diskutohen njësitet themelore të sistemit juridik (norma juridike, institutet e së drejtës, degët e së drejtës, grupet e së drejtës) - shqyrtohen teknikat themelore të interpretimit, mënyrat e zgjidhjes së çështjeve rreth zbrazëtirave juridike; (Kapitulli 14)
15	perseritje
16	Provimi Final
Parakushtet	
Studenti duhet të frekuentojë lëndën në masën minimale prej 75%.	
Literatura	
• Luan Omari, Parime dhe Institucione të se Drejtës Publike (2013)	
Referenca të tjera	
• Luan, Omari. "Shteti i së drejtës." (2002). • MacCormick, Neil. Institutions of law: an essay in legal theory. OUP Oxford, 2007 • Kelsen, Hans. General theory of law and state. Vol. 1. The Lawbook Exchange, Ltd., 1945	
Rezultatet e Lëndës dhe Kompetencat	
1	Studentet do të jenë në gjendje të njohin burimet e shtetit dhe të se drejtës.
2	Studentet do të njohin parimet kryesore të funksionimit të shtetit dhe institucioneve të tij.
3	Studentet do të njohin format kryesore të organizmit shtetëror.
4	Studentet do të njohin format kryesore të organizmit shtetëror.
5	Studentët do të mund të kenë njohuri të gjera rreth anës historike, politike, sociologjike dhe filozofike të së Drejtës Publike në Shqipëri.
6	Studentet do të jenë në gjendje të njohin burimet e shtetit dhe të se drejtës.

Mënyra e Vlerësimit të Lëndës			
Notat e Ndërmjetme	Sasia	Përqindja	
Gjysmë finale	1	40	
Kuize	0	0	
Projekte	0	0	
Projekte semestrale	0	0	
Punë laborator	0	0	
Pjesëmarrja në mësim	0	0	
Kontributi i notave të ndërmjetme mbi vlerësimin final			40
Kontributi i provimit final mbi vlerësimin final			60
Total			100
Ngarkesa ECTS (Në Bazë të Ngarkesës së Studentit)			
Aktivitetet	Sasia	Kohëzgjatja (orë)	Ngarkesa Totale (orë)
Kohëzgjatja e kursit (Duke përfshirë edhe javën e provimeve : 16x Orët totale të kursit)	16	4	64
Orët e studimit jashtë klase (Parapërgatitje, Praktika etj)	14	3	42
Detyra	0	0	0
Gjysmë finale	1	10	10
Provimi final	1	10	10
Të tjera	0	0	0
Ngarkesa totale e orëve			126
Ngarkesa totale e orëve / 25 (orë)			5.04
ECTS			5.00